



Prishtinë, 10 shtator 2010
Kodi i ZRRE-së: V_290_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
3. Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A) për derogim (shtyrje afati) në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes, të datës 15 qershor 2010,

Në seancën e mbajtur më 10 shtator 2010 nxjori këtë:

VENDIM

- I. **I LEJOHET** KEK SH.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të **Kodit të Shpërndarjes**, si në **Shtojcë** të këtij vendimi.

ARSYETIM

1. ZRRE me datë 15 qershor 2010 ka pranuar kërkesën e KEK SH.A-së për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes.
 2. ZRRE ka vlerësuar kërkesën dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi, dhe gjithashtu duke pasur parasysh gjendjen aktuale të sistemit të shpërndarjes, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 3. Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të Kodit të Shpërndarjes mbesin në fuqi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca me dispozitat e deroguara.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado të ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Theranda Beqiri, Anëtare

Blerim Koci, Anëtar

Shtojcë: Dispozitat e deroguara (shtyrje afati) të Kodit të Shpërndarjes së KEK SH.A-së

Nr .	Dispozita	Kërkesa për derogim deri më:	Arsyetimi i KEK-ut	Derogimi i datës 10.09.2010 deri me:
1	Dispozita 4.6 Standardet e Dizajnit	31 dhjetor 2010	Sistemi i Shpërndarjes për shkak të rrjetit të vjetruar si në tensionin e mesëm ashtu edhe në tensionin e ulët, për shkak të mbingarkesave të mëdha nuk mundet të operoj me tensione nominale.	31 dhjetor 2010
2	Dispozita 4.6.3 Kërkesat për Gjeneruesit e Pavarur të Energjisë të Lidhur Direkt në Sistemin e Shpërndarjes	31 dhjetor 2010	KEK-u ka përpiluar METODOLOGJINË TARIFORE PËR LIDHJE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES dhe deri më 30 qershor do të aplikojë në ZRRE për aprovim.	Nuk i lejohet derogimi , dhe kjo dispozitë duhet të implementohet nga OSSH-ja ashtu siç e përcakton Kodi i Shpërndarjes.
3	Dispozita 5.4 Informatat e Kërkuara për Kyçje	31 dhjetor 2010	KEK-u ka përpiluar METODOLOGJINË TARIFORE PËR LIDHJE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES dhe deri më 30 qershor do të aplikojë në ZRRE për aprovim. Në këtë Metodologji është përfshi edhe Metodologjia e Taksave për Kyçje në Sistemin e Shpërndarjes.	31 dhjetor 2010
4	Dispozita 5.7 Matja/Telemetria	31 dhjetor 2014	KEK-u ende nuk ka të instaluar ndonjë sistem për telekontrollim siç është SCADA, po ashtu edhe përdoruesit nuk kanë pajisje për telekontrollim. Shpresojmë se deri më 31.12.2014 do të instalohet SCADA.	31 dhjetor 2010
5	Dispozita 5.8 Aranzhimet Specifike	31 dhjetor 2010	KEK-u ka përpiluar METODOLOGJINË TARIFORE PËR LIDHJE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES dhe deri më 30 qershor do të aplikojë në ZRRE për aprovim. Në këtë Metodologji është përfshi edhe Metodologjia e Taksave për Kyçje në Sistemin e Shpërndarjes.	31 dhjetor 2010
6	Dispozita 6.1.4 Humbja e Qendrës së Kontrollit	31 dhjetor 2010	OSSH është duke punuar për formimin e qendrës së kontrollit dhe në proces është hartimi i Planit të krizës së qendrës së kontrollit.	31 dhjetor 2010
7	Dispozita 6.4 Komunikimi Operues dhe Veprimi	31 dhjetor 2014	OSSH është duke punuar për formimin e Qendrës Dispiçerike dhe implementimin të pajisjes SCADA.	31 dhjetor 2010
8	Dispozita 6.6 Testimi i Sistemit	31 dhjetor 2014	Përcaktimi i konfigurimit optimal të rrjetës distributive është detyrë komplekse që përcakton minimizimin e humbjes së fuqisë dhe energjisë, besueshmëri më e madhe e rrjetit, izolim termik i kabllove, rënia e tensioneve etj. Të gjitha këto mund të realizohen me teste teknike stimuluese, atëherë kur ndërtohet qendra Dispiçerike në Distribucion dhe me implementimin e pajisjes SCADA.	31 dhjetor 2010

--	--	--	--	--